

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE Departamenti i përgjithshëm, me Gjyqtarin Gezim Ademi, procesmbajtësen Saranda Shalaku, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehurit M.S. nga ... me vendbanim fsh. ..., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 me par.1 të KPRK-ës, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr 1171/2017, dt. 22.08.2018, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me dt.27.05.2019, ne mungese te prokurorit e ne prezence te pandehurit me datën 28.05.2019, e beri shpalljen ndërsa me datë 31.05.2019, merre këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari;

M.S., nga i ati ..., e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me ..., me vendbanim ne fshatin ..., komuna e ... ka te kryer shkollën fillore, i pamartuar, i pa pune, Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 03.06.2016 rreth orës 22.30 ne ... ne rrugën ‘...’ ne afërsi te stacionit te autobusëve me paramendim ka ushtruar force ndaj te dëmtuarit L.S. me te cilin me herët kishte mosmarrëveshje, është afruar dhe me duar e ka shtyrë dhe me grusht e ka goditur ne pjesën e fytyrës, i vetëdijshme me këtë ka kryer vepër qe ka desh ta kryej dhe i vetëdijshëm ndaj ndalesës për veprën e tij.

Me këtë ka kryer veprën penale-Sulmi nga neni 187 par 1 te KPRK-ës.

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,21,41,49,50,51,52,73, dhe 187 par.1 te KPRK-ës dhe nenit 365, 450,463 te KPP-ës:

G J Y K O N

ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJE PREJ 3 muaj, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale ne kohëzgjatjeje prej 1 (një) viti.

OBLIGOHET i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale - paushallin gjyqësor te paguaj shumen prej 10 euro, për fondin e kompensimit te viktimave te kriminit shumen prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Te dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike-kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.1171/2017, te dt. 22.08.2018, kundër te pandehurit M.S. nga fsh. ..., komuna e ..., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 te KPRK-ës .

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.27.05.2019, ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: se e ndjej veten fajtor për veprën penale dhe njëherit me vjen keq për rastin qe ka ndodhur dhe njëherit i premtom gjykatës se ne te ardhmen nuk do te kryej asnjë vepër tjetër penale.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori deklaroi: Ne baze te nenit 248 te KPP-ës po e jap pëlqimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, meqenëse se i njëjti ka dhënë pranimin ne mënyrë vullnetare, dhe pranimi është i mbështetur ne provat e propozuara ne aktakuze pasi qe ne shkresat e lendes nuk ekziston certifikata nga vepra penale, dhe se pajtohet se nuk ka qene i akuzuar për vepra tjera penale dhe duke marr parasysh si rrethane lehtësuese si dhe faktin qe ka deklaruar se pendohet veprën qe e ka kryer dhe nuk do te kryej këto vepra penale apo te ngjashme.

I. Vlerësimi i pranimit te fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e Gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuzat, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes si: Raporti Policor te këtij rasti me nr.2016-BC-577, deklaratën e te dëmtuarit L.S. e dhënë ne stacionin policor Mitrovica Jjugut me datën 04.06.2016, deklaratën e te pandehurit e dhënë ne stacionin policor Mitrovica Jug., nga te gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 187 par 1 te KPRK-ës.

II. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo vepër penale është e dënueshme me gjobë ose me burgim deri ne tre (3) vite, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale. Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e qe nga deklarimi i tij me rastin e pranimit te fajësisë i njëjti deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tille i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim te thelle te tij për veprën penale, si rrethane tjetër lehtësuese ka gjetur se i njëjti nuk ka qenë me parë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton dënim me kusht, nga se do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënimit. Nga te gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit.

III. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet procedurale- paushallin gjyqësor te paguaj shumen prej 10 Euro, si dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave shumen prej 30 Euro te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

IV. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450,463 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P. nr.701/2018 dt.31.05.2019

Procesmbajtësja :
Saranda Shalaku

Gjyqtari :
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate